



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "AEF" SH.P.K

URDHËR

"për vënien e sekuestros konservative"

Drejtuar : **Qendra Kombëtare e Biznesit**
Për dijeni : Shoqëria "Atrium" shpk (ish Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k) me NIPT L81828011Q
Për dijeni : Shoqëria F&M Reklama sh.p.k me NIPT L31716006E

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat të Shoqërisë "AEF BAILIFF SERVICE" sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është rregjistruar çështja përmbarrimore me palë :

Debitor : Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k(sot Shoqëria "Atrium" shpk) me NIPT L81528011Q
Kreditorit : Shoqëria F&M Reklama sh.p.k me NIPT L31716006E
Objekti : Likuidim detyrimi

Unë Përmbarruesi Gjyqësor Emiljano GJOZA pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarrimore,

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Fatura Tatimore Nr. Serie 63460035 datë 09.08.2018 është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 9273 datë 14.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt:

"Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv Fatura Tatimore Nr. Serie 63460035 datë 09.08.2018".

Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara ligjore dhe debitori nuk e ka përmbushur detyrimin, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros konservative për debitorin Shoqëria "Atrium" shpk (ish Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k) me NIPT L81828011Q me qëllim mos kryerjen e asnjë veprimi i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar.

Për këtë arsye si dhe në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative për debitorin Shoqëria "Atrium" shpk (ish Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k) me NIPT L81828011Q, me qëllim mos kryerjen e asnjë veprimi i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar.
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet ne 4 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

Zyra e Përmbarrimit Privat AEF shpk
Përmbarruesi Gjyqësor
Emiljano A Gjoza

